

Znj. Alije Belliu

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore me nr. 4642 prot., dt:17.4.2024, ju sqarojmë se:

Pasi shqyrtuam dosjen tuaj të përfitimit me nr. 109556/1, konstatuam se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier, në zbatim të neneve 31, 32, të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me vendim caktim pensioni nr. 2649 datë, 22.01.2010, ju ka caktuar pension të plotë pleqërie, me vjetërsi në punë 37 vite, me masë fillestare pensioni 18.316 lekë, me datë fillimi pagese 15.05.2009.

Në llogaritjen e vjetërsisë së punës për efekt pensioni, janë marrë periudhat e vjetërsisë në punë, të konfirmuara nga DRSSH Fier, si më poshtë:

- 01.10.1969 - 18.10.1970 SMT, Lushnje;
- 18.10.1970 - 28.02.2003 Arka kursimit, Lushnje;
- 01.11.2003 - 05.05.2007 Filiali postës Lushnje;
- 05.05.2007 - 30.06.2007 Filiali postës Lushnje.

Me vendim rishqyrtim pensioni nr. 2649/1, datë 31.05.2016, masa e pensionit është rishqyrtuar, duke shtuar periudhën e punës 01.03.2003 - 31.10.2003, 01.03.2008 - 05.01.2009, Filiali i Postës Lushnje dhe asistencën e përfituar nga kjo ndërmarrje. Nga rishqyrtimi i bërë, periudha e vjetërsisë në punë shkoi 38 vite e 6 muaj dhe masa fillestare e pensionit 18.431 lekë në muaj.

Me vendim rishqyrtim pensioni nr. 2649/2, datë 18.07.2019 është bërë rillogaritja e fundit e masës së pensionit, duke ju shtuar periudhën e punës 01.04.1968 - 20.07.1969, në Kooperativën Bujqësore Veleshnjë. Nga rishqyrtimi i bërë periudha e vjetërsisë në punë shkoi 39 vite e 11 muaj dhe masa fillestare e pensionit 18.595 lekë në muaj.

DRSSH Fier, sipas pikës 3, të nenit 62, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në të cilin citohet: "*Pensionet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet, ju ka dhënë edhe shtesën kreditore nga rishqyrtimi, për periudhën 01.08.2016 – 01.08.2019, në shumën 7.548 lekë.*

Në llogaritjen e vjetërsisë së punës nuk ju është marrë periudha shtator - nëntor 1967, si llogaritje në ish Kooperativën Bujqësore, Sheqëz, pasi nuk ka dokumenta që të pasqyrojnë këtë periudhë, bazuar në verifikimin e kryer nga DRSSH Berat.

Me kërkesë nr. 9313 prot., datë 08.10.2021, i jeni drejtuar Komisionit Rajonal të Ankimit pranë DRSSH, Fier, për rishikim të viteve të punës. Ky komision, me shkresën kthim përgjigje nr. 9313/1

prot., datë 13.10.2021, ju ka bërë me dije se ankesa juaj është shqyrtuar njëherë me të njëjtin objekt kërkesë.

Diploma e shkollës, ju është kërkuar për të përcaktuar saktë, pagën referuese si specialiste e mesme, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 561, datë 12.08.2005 “Për caktimin e pagave referuese për caktimin e pensioneve”.

Faleminderit për mirëkuptimin.